



Instituti për Bashkitë Shqiptare
'për qytete të qëndrueshme'

No-prot

Tiranë, 20 Nëntor 2023

Lënda: Rekomandime të Institutit për Bashkitë mbi Projekt Buxhetin e Shtetit për vitin 2024

Drejtuar: Komisionit të Ligjeve, Kuvendi i Shqipërisë

Instituti për Bashkitë e Shqipërisë si një nga aktoret profesionale dhe teknike në fushën e pushtetit vendor, duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe vazhdueshmërinë ju prazanton disa kërkesa për ndryshim të projektit buxhetor për vitin 2024 për pushtetin vendor.

IBSH vleron dhe mirkupton të gjitha përparësitë pozitive, sikundër mirkupton vështirësitë dhe potencialin e mundësive në dimensionin e buxhetit kombëtar në tërësi dhe buxhetit vendor në veçanti.

IBSH njih shumë mirë edhe nevojat reale që ka sot pushteti vendor për mjete financiare po jo vetëm.

Sot, 61 bashkitë dhe Njësitë Administrative përkatëse kanë më shumë se kurrë përgjegjësi. Janë 42 funksione dhe llojshmëri shërbimesh administrative dhe publike, për të cilat ju nevojitet mbështetje serioze me buxhet nga transferata qeveritare.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë na ka prezantuar një projekt - buxhet për pushtetin vendor për vitin 2022 si më poshtë:

- a) Pjesa përgjithshme prej 24,343 miliard lekë që rezultojnë nga zbatimi i pikës 2 të nenit 23 të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", i cili përcakton se madhësia e transferatës së pakushtëzuar për vitin 2024 është jo më pak se 1% e Produktit të Brendshëm Bruto dhe jo më pak se ajo e vitit 2023;
- b) Pjesa sektoriale prej 10,740 miliard lekë nga shtesa që rezultojnë si pasojë e zbatimit të pikës 3 të nenit 95 të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", për përfundimin e periudhës tranzitore për financimin me transferata specifike të funksioneve të decentralizuara nga ky ligj, dhe zbatimi i pikës 4 të nenit 23 të Ligjit nr. 68 datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" që rregullon konvertimin e transferatave specifike për funksionet e decentralizuara rishtazi në nivel vendor në transferata të pakushtëzuar sektoriale; dhe
- c) Fondi për pagat prej 1,500 miliard lekë nga shtesa që rezultojnë si pasojë e zbatimit të pikës 15, a) të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.328 datë 31.5.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt pagese, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të nëpunësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore".



Instituti për Bashkitë Shqiptare
'për qytete të qëndrueshme'

IBSH vlereson rritjen e buxhetin me 5.5 miliard dhe fondin për rritjen e pagave për të cilën mendon se do justifikohet dhe konvertohet në shërbim më të mirë dhe transparent për qytetaret, si dhe do motivojë burimet njerzore në bashki.

IBSH kupton që asnjë qeveri nuk ka para me bollëk që plotësojnë çdo dëshirë dhe kërkesë të çdo pushteti.

Por, ne besojmë seriozisht se ka hapsira për përmirësime. Ne propozojmë shtesë buxheti të transfertat e përgjithshme sektoriale. Konkretisht:

- 1-Buxheti për Mbrojtje nga Zjarri nga 1 546 805 i planifikuar të shkojë në 3.000.000*
- 2-Buxheti për Administrimin e Atyeve nga 468.559 i planifikuar të shkojë në 1.000.000*
- 3-Buxheti për Rrugët Rurale nga 646628 i planifikuar të shkojë në 1.200.000*
- 4-Buxheti për Ujitje dhe Kullim nga 1.037.307 i planifikuar të shkojë në 2.500.000*

Vijmë në këto propozime konkrete referuar nevojave që kanë bashkitë për të dhënë një frymarrje me ekonomike zonave rurale ku dhe problemet ekonomike dhe sociale janë më evidente.

IBSH mbetet e gatshëm për bashkëpunim për sa i përket rritjes së kapaciteteve vendore, performancës së vetë bashkive dhe përmbushjes së detyrimeve ligjore.

Faleminderit

Instituti për Bashkitë e Shqipërisë

Agron Haxhimali

Drejtor Ekzekutiv